



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 07/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Malishevë, paraqitur kundër Avokatit të Popullit Sami Kurteshi, për shkak të manipulimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), A nr- 07/11 të datës 09.01.2011

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se Avokati i Popullit Sami Kurteshi, në fshatin Drenoc në VV 3008/A rreth orës 10:15 kishte qëndruar në një lokal ushqimorë afërsi prej 50 metra nga QV në prani të dhjetra qytetarëve duke lavdëruar kandidatin e LVV-së Ismail Kurteshin ka lobuar në mënyrë që ai të votohet nga votuesit e këtij lokaliteti.

Sipas parashtrësies të ankesës Avokati i Popullit Sami Kurteshi, kandidatin Ismail Kurteshi e ka quajtur njeri të drejtë, njeri që nuk vjedh, njeri largpamës, besnik dhe i vendosur, gjë që ka lobuar në kohën që me ligj konsiderohet heshtje zgjedhore.

Dega e PDK-së në Malishevë, vlerëson se në rastin konkret Avokati i Popullit ka dëmtuar degën dhe ka bërë shkelje të LZP-së.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi Avokatin e Popullit Sami Kurteshi, më datë 10.01.2011, për ankesën që është bërë nga subjekti politik PDK dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.01.2011, gjërë në ora 12:00. PZAP-i, pranoi përgjigjeje në ankesë nga Avokati i Popullit Sami Kurteshi sipas afatit të caktuar për të sqaruar lidhur me shkeljen e heshtjes zgjedhore siç ka pretenduar pala ankuese, në të cilën theksohet se në funksionin e Avokatit të Popullit, më 09 janar 2011 ka qenë në mision të vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare, i certifikuar nga KQZ, me

numër të kartelës 925 dhe si udhëheqës i këtij institucioni ka udhëhequr vëzhgimin duke koordinuar ekipet e IAP-it në të gjitha komunat.

Ai shtoi se gjatë ditës së zgjedhjeve më 9 janar 2011 ka qenë në QVV të ndryshme për të vëzhguar në të gjitha QV në të cilat është mbajtur rivotimi, ai ka pranuar se pas përfundimit të vëzhgimit të procesit të votimit në fshatin Drenoc diku rreth orës 09:30 ka hyrë në një shitore pran shkollës ku ishte QV me vëzhguesit tjerë dhe aty kishte takuar disa persona të cilët e kanë njohur nga paraqitja publike të cilët nuk i ka njohur, njëri ndër këta persona kishte qenë edhe drejtori i asaj shkolle i cili në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 kishte qenë i certifikuar për zgjedhje, ndërsa për zgjedhjet e 9 janarit 2011 ai nuk ishte certifikuar dhe duke biseduar me te, ai e kishte pyetur për Ismail Kurteshin kandidatin për deputet në Parlamentin e Kosovës duke menduar se ishin vëllezër kishte filluar ta lavdëronte me ç'rast Sami Kurteshi e ka korrigjuar duke i thënë se ai është djali i axhës së tij e jo vëllai siç ka shprehur personi i cili ishte paraqitur si drejtor i asaj shkolle dhe me këtë rast nuk është përmendur fare ndonjë fakt tjetër e as subjekti politik të cilit i takon Ismail Kurteshi. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka shtuar se pas 4-5 minutave ka dal nga shitorja dhe së bashku me bashkëpunëtorët e tij ishte nisur për në Deçan për të vazhduar vëzhgimin e procesit zgjedhor.

Avokati i Popullit, Sami Kurteshi deklaroj se me përgjegjësi të plotë legale, morale dhe materiale se në asnjë rast nuk ka përmendur asnjë emër të kandidatëve për Zgjedhje e Përgjithshme Parlamentare në Republikën e Kosovës, e as në rastin konkret në fshatin Drenoc të Malishevës më datë 9 janar 2011.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

*(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizo shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore më datë 9 janar 2011, nga Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, janë të pabazuara për shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Këtë e bënë edhe më të besueshëm përgjigjja në ankesë e datës 11.01.2011, lidhur me ditën e rivotimit të datës 09.01.2011 në fshatin Drenoc komuna e Malishevës, në të cilën theksohet se: Avokati i Popullit Sami Kurteshi ka qenë vëzhgues i certifikuar nga ana e KQZ-së me nr. të kartelës 925, për zgjedhjet 9 janarit 2011 dhe si i tillë ai ka udhëhequr dhe koordinuar ekipet e mobile të IAP-së në të gjitha komunat e Kosovës për të vëzhguar zgjedhjet. Deklarata e Avokatit të Popullit, Sami Kurteshi të cilën e ka

dhënë në përgjigje në ankesë se: ka përgjegjësi legale, morale dhe materiale se në asnjë rast dhe në asnjë vend nuk ka përmendur asnjë emër të kandidatëve për deputet në Parlamentin e Kosovës e as në rastin konkret siç ka pretenduar pala ankuese në fshatin Drenoc- Malishevë.

Andaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi I të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 07/2011 më datën 13.01.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

